



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLICA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primišteno / Predato Received / Delivery	06.04.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	3356	/2023	1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 387/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e dhe Vendosijen e Ankesave nga: Eshref Shabani kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.387/2023 të datës 21.02.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ me adrese banimi _____

kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 05.04.2023, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.387/2023 të datës 21.02.2023 të parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Nëpunësi Civil _____ i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, më datë 21.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1957/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me shkrim të datës 16.02.2023 të organit të punësimit/Zyrës së Personelit të Komunës së Mitrovicës së Jugut lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit për shtesat mbi pagën bazë për kushtet specifike të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 28.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa Këshilli,

me datë 15.03.2023 përmes emalit ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe duke marrë për bazë legjislacionin përkatës që rregullon këtë natyrë të kësaj çështje, konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar, sepse:

Nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se ankuesi është i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut në pozitën e punës "Udhëheqës i Sektorit të Shërbimeve Publike dhe Mbrojtje të Mjedisit" ndërsa ankuesi në ankesën e tij pretendon se i takon shtesa mbi pagën bazë për shkak të kushteve specifike në punë bazuar në Ligjin Nr.04/L-186 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-181 për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut i cili ishte në fuqi nga data 15.05.2013, pasi në Nenin 10.A përcaktohej: "1. Inspektorëve të tregut i njihet e drejta e marrjes së pagesës shtesë mbi pagën bazë, për shkak të kushteve specifike në punë 2. Shtesat sipas paragrafit 1. të këtij neni do të bëhen konform Ligjit përkatës për shërbimin civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjit përkatës për pagat e nëpunësve civil", ndërsa referuar kësaj kërkesë të datës 21.12.2022, kolegji i këshillit konstaton se përkundër faktit se ankuesi ka qenë në dijeni lidhur me këtë çështje nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik-administrativ në kuptim të realizimit të kësaj kërkesë deri më datën e lartshënuar të adresimit të kërkesës në organin e punësimit të tij, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 14.02.2013), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohej se: "130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin", e që në këtë kuptim duke pasur parasysh faktin se përkundër që ligji mbi të cilin e bazon ankesën tashmë ankuesi ka qenë në fuqi nga viti 2013 por se nuk është argumentuar me asnjë provë nga ankuesi se kishte ndërmarrë veprime të caktuara administrative me qëllim të realizimit të kësaj kërkesë, andaj në këtë kuptim të këtij pretendimi dhe dispozitave të Ligjit të Procedurës Administrative që ka qenë në fuqi dhe të specifikuara më lartë ankesa është e palejuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të shkresave kryesore që lidhen me pretendimin e ankuesit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik që ka hy në fuqi me 05.02.2023, i cili ligj në nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin parasheh: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", ndërsa në nenin 22 paragrafi 1 të këtij ligji parasheh: "1. Shtesat që mund përfitohen në bazë të këtij ligji janë:1.2. shtesa për kushte tregu të punës.....", po ashtu në nenin 26 paragrafi 1 deri në 5 parasheh: "1. Shtesa për kushte specifike të punës përfitohet nga zyrtaret/ët publik dhe të punësuarat/it e tjerë që janë të ekspozuar ndaj rrezikshmërisë në vendin e punës ose kanë kushte specifike të punës që ua rrezikojnë jetën dhe/apo shëndetin....4. Me rastin e krijimit të funksioneve, pozitive, apo emërtesat e reja sipas nenit 42 të këtij ligji, institucioni në të cilin krijohet pozita, kur e vlerëson se kësaj pozite duhet ti takoj shtesa për kushte specifike të punës, kërkon nga ministria përgjegjëse për administratën publike dhe ministria përgjegjëse e financave pëlqimin për përfitim të kësaj shtese. 5. Pozitat përkatëse për të cilat përfitohet shtesa për kushte specifike të punës, vlera dhe procedura për përfitimin e saj miratohen me akt nënligjor nga Qeveria pas propozimit nga ministria përgjegjëse për financa".

Po ashtu kolegji i këshillit me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese analizoi edhe dispozitën e nenit 42 të Ligjit Nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik sa i përket përcaktimit të ekuivalencës i cili nënë në paragrafin 1 parasheh: "1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve të pagave", ndërsa neni 45 paragrafi 2 sa i përket shfuqizimit të dispozitave tjera ligjore dhe akteve nënligjore parasheh: "2. Me hyrje në fuqi të këtij ligji shfuqizohet gjithashtu çdo dispozitë e ligjit apo e aktit nënligjor tjetër që rregullon çështjen e pagës, kompensimeve, shtesave, shpërblimeve apo kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht për t'u nxjerr nga dispozitat e këtij ligji", duke përfshi edhe Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe aktet nënligjore që kishin derivuar nga ky ligj, mbi të cilin ishte i bazuar ligji nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut sa i përket shtesave mbi pagën bazë për kushte specifike në punë, ligj mbi të cilin e bazon pretendimin ankuesi, e që në këtë kuptim si më lartë është kompetencë e institucioneve shtetërore kompetente që të ndërmarrin veprimet adekuate ligjore për implementim të këtij ligji, dhe se çdo veprim, duke përfshi edhe kërkesat e natyrës financiare apo ankesat që lidhen me çështje që ky ligj i rregullon pa ndjekur procedurat që i parasheh ky ligj janë të parakohshme nga se ende nuk është kompletuar infrastruktura ligjore si parakusht për realizimin e kërkesave të kësaj natyre.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në lidhje me objektin e kësaj ankese ka konstatuar se tashmë Qeveria e Republikës së Kosovës më datë 06.02.2023 ka nxjerrë Rregulloren (QRK) Nr. 08/2023 për shtesat për të punësuarit në sektorin publik, në nenin 1 sa i përket qëllimit të kësaj rregullore e njëjta parasheh: "1. Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë kriteret, kushtet, rregullat, mënyrën e llogaritjes dhe procedurën për përfitimin e shtesave të mëposhtme për të punësuarit në sektorin publik: "..... 1.2.shtesa e kushteve specifike të punës.....,etj", ndërsa në nenin 7, sa i përket procedurës për përfitimin e shtesës për kushte specifike të punës, e cila rregullore në paragrafët 1 deri 7 parasheh: "1. Secili institucion që vlerëson se ka zyrtarë publikë dhe të punësuar të tjerë që plotësojnë kriteret për të përfituar këtë shtesë dorëzon kërkesën për miratim të shtesës për pozitat përkatëse tek Komisioni sipas paragrafit 2 të këtij neni, me të dhënat si në vijim: 1.1. pozitën dhe numrin e të punësuarve në këtë pozitë; 1.2. përshkrimin e punës të punësuarit; 1.3. arsyetimin e detajuar për përfitimin e shtesës; 1.4. klasën dhe koeficientin. 2. Kërkesa sipas paragrafit 1, dorëzohet tek Komisioni i cili themelohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, me mandat tre (3) vjeçar, në këtë përbërje: 2.1. përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit; 2.2. përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për financa; 2.3. përfaqësues nga Ministria përgjegjëse për Administratë Publike. 3. Anëtarët e Komisionit janë nëpunës civil, ku njëri nga përfaqësuesit është Kryesues i Komisionit. Komisioni është përgjegjës të përpiloj raport përfundimtar në bazë të kërkesave të institucioneve sipas paragrafit 1 të këtij neni, i cili duhet të përmbaj: 4.1.lista me pozitat për të cilat kërkohet shtesa e kushteve specifike të punës, të cilat i plotësojnë kushtet e përcaktuara në ligjin përkatës për pagat dhe dispozitat e kësaj Rregulloreje; 4.2.vlerën indikative të rekomanduar për secilën kategori potencialisht përfituese të shtesës për kushte specifike të punës, duke respektuar kufizimet buxhetore të përcaktuara me legjislacionin në fuqi; 4.3.shkaqet për mos përfshirjen e kërkesave të tjera të pranuar në përfitimin e shtesës; dhe 4.4.informatat tjera që konsiderohen relevante nga Komisioni. 5.Me nxjerrjen e raportit përfundimtar, Komisioni dërgon të njëjtin për miratim në Qeverinë e Republikës së Kosovës. 6.Qeveria, pas marrjes së pëlqimit nga Ministria përgjegjëse për financa, miraton të gjeturat e Komisionit përmes vendimit qeveritar. 7.Komisioni, në çdo kohë dhe në bazë të kërkesës së institucioneve, mund të rishikojë listën e aprovuar në Qeveri dhe të propozojë ndryshimin e saj", andaj kolegji i këshillit bazuar në dispozitat e lartshënuara të Rregullores (QRK) Nr. 08/2023 për shtesat për të punësuarit në sektorin publik, konstaton se përderisa nuk respektohen procedurat sipas kësaj rregullore brenda institucioneve përkatëse, ankesa në këshill është e parakohshme.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke marrë për bazë dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përkatësisht nenin 16 paragrafi 4 ku parashihet :*“4. Para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t’i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe”*, e në kuptim të kësaj dispozite dhe legjislacionit të potencuar si më lartë përkatësisht Ligjit Nr. 08/L-196 për pagat në sektorin publik dhe Rregullores (QRK) Nr. 08/2023, nënkuptohet se ankuesi do të duhej të ndërmerr veprimet konform këtij legjislacioni dhe përderisa nuk ka ndonjë përgjigje zyrtare nga institucioni përkatës në kuptim të respektimit të këtyre dispozitave të cituara më lartë në arsyetim të këtij vendimi dhe përderisa ankuesi me asnjë provë nuk ka dëshmuar se janë ndërmarrë veprimet adekuate sipas legjislacionit në fuqi që rregullon këtë çështje përkundër një përgjigjeje të institucionit me që rast konstatohet se nuk janë ndërmarrë veprimet që parasheh legjislacioni i potencuar si më lartë , dhe duke pas parasysh faktin se ende nuk është kompletuar infrastruktura ligjore për realizimin e kërkesave të kësaj natyre ,ankesa në këshill është e parakohshme përkatësisht rezulton të jetë e palejuar në këtë kohë nga arsyet e potencuar më lartë.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr. 387/2023

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



- Vendimi i dërgohet:**
- Ankuesit
 - Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
 - Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut; dhe
 - Arkivit të KPMShCK-së

